

UDHËZIM
Nr. 6, datë 20.4.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE”, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Në pikën 2.3, fjalia me përmbajtje: “Drejtoritë rajonale tatimore që të lëshojnë vërtetim, “Për shlyerjen e detyrimeve tatimore”, për çdo tatimpagues duhet të kërkojnë më parë vërtetim nga drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor për shlyerjen e “Taksës vjetore të mjeteve të përdorura”, të mjeteve në pronësi të tatimpaguesit”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj